

Master Profesional në Ekonomi dhe Biznes, *profili* "Financë - Kontabilitet"

Programi Master Profesional në Financë - Kontabilitet synon të formojë profesionistin përmes rritjes së dijeve bashkëkohore dhe aftësive praktike, për t'u përballur me botën komplekse të menaxhimit financiar. Studimet Master, me ndihmën e pedagogëve ndër më profesionistët në vend, e ndihmojnë studentin të mësojë nga praktikat më të mira të zbatuara në aktivitetin e përditshëm të një financieri, që lidhen me taksimin, buxhetimin, analizën financiare dhe të kostos, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, auditimin, bankingun ndërkombëtar, menaxhimin e riskut bankar, etj.

Kurrikula

- o Drejtim i avancuar në financë dhe investime;
- o Taksim;
- o Buxhetimi dhe analiza financiare;
- o Standartet ndërkombëtare të raportimit financiar;
- o Kontabël i avancuar.

Karriera

Mundësi punësimi si financiar në:

- o institucione të ndryshme publike në nivel qendror dhe lokal;
- o kompani publike apo private;
- o organizata jofitimprurëse.



Kohëzgjatja & Forma e studimit

Studime me kohë të plotë

Kohëzgjatja normale e studimeve në program
✓ **1 vit akademik.**

Kohëzgjatja maksimale e studimeve në program
✓ **2 vite akademikë**

Kriteret

- o Kanë përfunduar dhe janë diplomuar në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licensuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe i akredituar në momentin e diplomimit të studentit;
- o Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licensuar dhe akredituar dhe diploma e tyre është njehtësuar nga MASR/QSHA.

Dokumentacioni mbështetës për aplikim:

1. Fotokopje Kartë Identiteti / pasaportë;
2. Fotokopje e diplomës së ciklit të parë e noterizuar / diplomë tjetër studimi e fituar jashtë shtetit dhe e njehsuar nga MASR;
3. Vërtetim i listës së notave dhe krediteve / suplementi i diplomës;
4. Fotokopje e noterizuar e diplomës së Maturës Shtetërore + Çertifikatë e notave, e konfirmuar nga DAR/ZA.
5. CV;
6. 2 fotografi;
7. Mandatë pagesa për tarifën e aplikimit të kryer në UniBa.



Kontakte të departamentit:

☎ +355 69 20 67 247 | +355 69 20 41 222

✉ Email: dept.finance@umb.edu.al